



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Katë V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 515/2022

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30. 09. 2022, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik OE "VB. TOFAJ" SH.P.K. me seli në Junik, për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakovë-kontrate dy vjeçare" me numër të prokurimit :632-22-5416-5-1-1 dhe numër të brendshëm 632-22-037-511, iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 19.10.2022, mori këtë:

VENDIM

Hedhet si e pa lejuar, ankesa e OE "OE "VB. TOFAJ" SH.P.K. me seli në Junik, lidhur me aktivitetin e prokurimit " Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakovë-kontrate dy vjeçare" me numër të prokurimit :632-22-5416-5-1-1 dhe numër të brendshëm 632-22-037-511, iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës.

I Lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Gjakovës, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakovë-kontrate dy vjeçare" me numër të prokurimit :632-22-5416-5-1-1 dhe numër të brendshëm 632-22-037-511,(përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankese tjetër).

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores

të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 06.10.2022, ka pranuar ankesë nga OE “VB. TOFAJ” SH.P.K. me seli në Junik për aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakove-kontrate dy vjeçare” me numër të prokurimit :632-22-5416-5-1-1 dhe numër të brendshëm 632-22-037-511, iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 515/2022.

Për aktivitetin prokurimit në fjalë autoriteti kontraktues me datën 12.09.2022 ka publikuar B58-Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues (Njoftim për anulim të aktiviteti të prokurimit) dhe Letrat Standarde.

OE “VB. TOFAJ” SH.P.K. me seli në Junik, me datën 22.09.2022, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Autoritetin kontraktues me datën 26.09.2022, e njofton OE ankues se kërkesa e tyre nuk do të shqyrtohet sepse e njëjta kërkesë është e jashtafatshme .

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërehet se OE ankues ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim sepse AK me datën 12.09.2022 ka publikuar , B58- Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues (Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit) dhe Letrat Standarde, kurse OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën 22.09.2022, pra OE ankues ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim ditën e 10 /dhjetë, e jo, *brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.*

Ku paragrafi 3.3 i nenit 108/A i Ligjit për Prokurim Publik specifikon në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, *brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.*

Dhe neni 4.1 pika (c) e Rregullave të Paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon:

Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të beje me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE: “VB. TOFAJ” SH.P.K. me seli në Junik, e datës 06.10.2022 me numër të

Protokollit 515/2022, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar në kundërshtim me pagrafin 3.3 të nenit 108/A të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 4.1 pika (c) e “Rregullave Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Kryetarja e OSHP-së
[Signature]
Vjosa Gradinaj Mexhuani

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Gjakovës

1x1 OE “VB. TOFAJ” SH.P.K. me seli në Junik

1x1 Arhivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së